

## **AJDA ÇARÇANI**

**Titulli:** MsC

**Fusha e ekspertizës kërkimore:** Kompozimi, forma dhe hapsira në Arkitekturë.

Profesor Ajda Çarçani ka studiuar për Arkitekturë në Universitetin Politeknik të Tiranës/Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës – dega Arkitekturë, Tiranë, Shqipëri.

Ajo ka kryer studimet universitare dhe ato post-universitare (Bachelor dhe Master) në Arkitekturë dhe është diplomuar në korrik të vitit 2012. Ka një eksperiencë të gjatë profesionale si arkitekte pranë studios së projektimit TOTA shpk. Ajo ka kryer një vit praktike profesionale pranë Bashkisë së Tiranës në sektorin e Planeve të Detajuara Vendore në përfundim të studimeve të saj. Ark.Çarçani është angazhuar si pedagoge pranë Universitetit Marin Barleti në lëndët e projektimit dhe të Kompozimit prej disa vitesh, dhe në të njëjtën kohë ajo është e përfshirë pranë institutit ADRIAPOL dhe BIRD ku merret me projekte të ndryshme lidhur me ndërtime, rindërtime, rikonstruksione dhe rikualifikim urban të zonave të ndryshme. Ark.Çarçani ka qenë disa herë lektore e ftuar në Universitetin Politeknik të Barit, në kuadër të programit Erasmus+ të Komisionit Evropian. Ark. Çarçani është përfshirë në projekte të ndryshme të pavarura arkitektonike kryesisht në fushën e interior design.